



"BBF"—Sh. A

Televizion

Tiranë më 15. 10. 2015

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A.

Prot. 51 Nr

Vendim: Nr...23

Tiranë më 15. 10. 2015

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, në përputhje me Ligjin Nr. 9901. Dt. 14. 04. 2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë, zhvilloi Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme më datën 15. 10. 2015 në Hotel "MONDIAL" në Tiranë . Në mbledhje morën pjesë gjithë aksionerët, që janë posedues të të gjitha aksioneve të kësaj Shoqërie (Aksioneri Flamur KALIVAÇI, shoqërohej edhe nga avokati i tij), Antarët e Këshillit Administrativ në detyrë, Administratori në detyrë, se bashku me përgjegjësit kryesor të sektoreve të administratës. Për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes u zbatuan në maksimumin e mundshëm të gjitha porcedurat dhe rregullat, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Shoqërisë. Rendi i ditës ishte:

1. Miratimi i rritjes së Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, sipas Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar(ALB—AUDIT), apo sipas propozimit të vetë Aksionerëve. Mos miratimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë, si kërkesë e detyrueshme e Ligjit Nr. 10475, datë 27. 10. 2011 dhe në përputhje me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, datë 16. 07. 2015, për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë "BBF" Sh A. marrjen e vendimit për cuarjen e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh.A, automatikisht në Likujdim.
2. Marrja e një Vendimi nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, për Organet Drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Administrativ). Si kërkesë e detyrueshme e Ligjit Nr. 9901, datë 14. 04.2008, i ndryshuar me ndryshimet përkatëse. " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pasi Shoqëria është pa organe drejtuese dhe përfaqësuese Ligjore, mos marrja e një Vendimi dhe mos gjetja e konsensusit për një zgjidhje emergjente deri në një zgjidhje definitive, miratimin nga Asambleja e Shoqërisë "BBF" Sh A, për cuarjen automatikisht të Shoqërisë në likujdim.

VENDOSI:

Zmadhimin e Kapitalit themeltar të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, në përputhje me detyrimet ligjore të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar nga Ligji Nr. 10475, datë 27.10.2011, konkretisht Neni 1, ku thotë: "Neni 107, pika 1 ndryshon si më poshtë: Shoqëria Aksionere me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3.500.000 Lekë".

Kapitali do zmadhohet, në mënyrë të barabartë sipas % të aksioneve që zotërojnë aksionerët.

Zmadhimi i kapitalit do të realizohet nga fitimet e shoqërisë, të cilat janë gjëndje të pa shpërndara në bilancin e Shoqërisëme 31 Dhjetor 2014.

Kapitali i Shoqërisë nga 2 000 000 Lekë që është aktualisht, bëhet 3 500 000 Lekë (Tre milion e pesë qind mijë Lekë), në minimumin e lejuar nga Ligji. Bazuar në Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar dhe Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, që kapitali të rritet me 1 500 000 Lekë (Një milion e pesë qind mijë Lekë), me obsionin për tu parë në periudhat pasardhëse, për tu zmadhuar në vlerën e plotë të propozuar nga Eksperti Kontabël i Autorizuar.

Bashkëngjitur këtij vendimi do të jetë edhe proces—verbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, Raporti i Ekspertit Kontabël të Autorizuar, si dhe Deklarata e Administratorit të Shoqërisë në përputhje me Nenin 178 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar dhe kërkesave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Ngarkohet Administratori në detyrë i Shoqërisë Z. Fejzo SUBASHI për të bërë depozitimin dhe regjistrimin e këtij vendimi në QKR, në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 " Për QKR-në"

Për Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A.

AKSIONERËT

Blendi KALIVACI

Flamur KALIVACI



K/Sekretaria

Silva DINGO (MOKRËRI)



"BBF"—Sh. A

Televizion

Tiranë më 15. 10. 2015

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A.

Prot. 52 Nr

Vendim: Nr. 23/1

Tiranë më 15. 10. 2015



Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, në përputhje me Ligjin Nr. 9901. Dt. 14. 04. 2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë, zhvilloi Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme më datën 15. 10. 2015 në Hotel "MONDIAL" në Tiranë . Në mbledhje morën pjesë gjithë aksionerët, që janë posedues të të gjitha aksioneve të kësaj Shoqërie (Aksioneri Flamur KALIVAÇI, shoqërohej edhe nga avokati i tij), Antarët e Këshillit Administrativ në detyrë, Administratori në detyrë, se bashku me përgjegjësit kryesor të sektoreve të administratës. Për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes u zbatuan në maksimumin e mundshëm të gjitha porcedurat dhe rregullat, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Shoqërisë. Rendi i ditës ishte:

1. Miratimi i rritjes së Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, sipas Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar(ALB—AUDIT), apo sipas propozimit të vetë Aksionerëve. Mos miratimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë, si kërkesë e detyrueshme e Ligjit Nr. 10475, datë 27. 10. 2011 dhe në përputhje me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, datë 16. 07. 2015, për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë "BBF" Sh A. marrjen e vendimit për cuarjen e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh.A, automatikisht në Likujdim.
2. Marrja e një Vendimi nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, për Organet Drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Administrativ). Si kërkesë e detyrueshme e Ligjit Nr. 9901, datë 14. 04.2008, i ndryshuar me ndryshimet përkatëse. " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pasi Shoqëria është pa organe drejtuese dhe përfaqësuese Ligjore, mos marrja e një Vendimi dhe mos gjetja e konsensusit për një zgjidhje emergjente deri në një zgjidhje definitive, miratimin nga Asambleja e Shoqërisë "BBF" Sh A, për cuarjen automatikisht të Shoqërisë në likujdim.



Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, të gjithë poseduesit e aksioneve, si dhe në pikën e parë janë kundër çuarjes së Shoqërisë në Likujdim. Në lidhje me këtë pikë u hodh propozimi që; Deri në gjetjen e dakortësisë për formulën e re të Këshillit Administrativ, i cili kërkon edhe ndryshime në statut, të zgjatet mandati i Antarve të Këshillit Administrativ në detyrë, të cilëve iu ka mbaruar mandati, deri në Zgjedhjen e Antarve të rinj të Këshillit Administrativ. Ky propozim u hodh në votim. Në votim propozimi mori 100 % të votave. Në bazë të votimit të realizuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës

VENDOSI:

Zgjatjen e Mandatit të Antarve të Këshillit Administrativ, të cilëve u ka mbaruar mandati, deri në gjetjen e dakortësisë nga poseduesit e aksionerve për formulën e zgjedhjes së Antarëve të Këshillit Administrativ. Një vendim i detyrueshëm dhe i domosdoshëm ky, për të mos lenë Shoqërinë pa organe drejtuesë, pasi një situatë e tillë e çon shoqërinë drejtë nismave për Likujdimin e saj. Nismat, në zbatim të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 i ndryshuar "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" mund të merren edhe nga persona të tretë. Të gjithë poseduesit e aksioneve janë kundra nismave për të çuar Shoqërinë drejt likujdimit.

Antarët e Këshillit Administrativ në detyrë, të cilëve u zgjatet mandati deri në zgjedhjen e antarëve të rinj janë: (Enkelda KALIVAÇI, Aferdita FERKO, Blendi KALIVAÇI)

Mandati i tyre do të ndërpritet me zgjedhjen e antarëve të rinj. Deri atëhere, ata do të ushtrojnë detyrën e funksionet e tyre në përputhje me Statutin e Shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi, konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar.

Përfitmi financiar i tyre gjatë ushtrimit të funksionit, do të jetë e njëjta vlerë që merrnin deri më sot.

Bashkëngjitur këtij vendimi do të jetë edhe proces—verbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerve të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A.

Ngarkohet Administratori në detyrë i Shoqërisë Z. Fejzo SUBASHI për të bërë depozitimin dhe regjistrimin e këtij vendimi në QKR, në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007." Për QKR-në".

Për Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh A.

AKSIONERËT

Blendi KALIVACI
Flamur KALIVACI



K/Sekretarja

Silva DINGO (MOKRËRI)



"BBF"—Sh. A

Televizion

Tiranë më 15. 10. 2015

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh. A.

Prot. 53 Nr. 1

Vendim: Nr. 23/15

Tiranë më 15. 10. 2015

Shtesë Vendimi

Në Vendimin Nr.23, datë 15.10.2015, të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" SH A, në faqen 2 (dy) të tij, pas paragrafit katër shtohet ky paragraf:

Pas Zmadhimit të Kapitalit, Kapitalit i Shoqërisë Aksionere "BBF" SHA bëhet 3 500 000 (tre milion e pesqindë mijë) Lekë, i ndarë në 3 500 (tre mijë e pesqindë) Aksione, të cilat zotërohen nga:

1. Blendi KALIVAÇI 50% ose 1750 (një mijë e shtatë qindë e pesëdhjetë) Aksione
2. Flamur KALIVAÇI 50% ose 1750 (një mijë e shtatë qindë e pesëdhjetë) Aksione

Ngarkohet Administratori në detyrë i Shoqërisë Z. Fejzo SUBASHI për të bërë depozitim dhe regjistrimin e këtij vendimi në QKR. Në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007." Për QKR-në"

Për Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë Aksionere "BBF" Sh. A.

AKSIONERËT

Blendi KALIVACI

Flamur KALIVACI



K/Sekretarja

Silva DINGO (MOKRËRI)